REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 2493 REP. NR. 871 KOL./1

# KONTRATE SHITJE

## Kuota kapitali

*Ne Tirane, sot date* ***05 Tetor 2018*** *(dymije e tetembedhjete), dite e premte, para meje Notere Alma I. POSHI, me seli ne Rrugen "Sulejman Delvina", Nr. 57, Tirane, u paraqitën personalisht personat e mëposhtëm dhe kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate si vijon:*

**SHITËSI:**

**Indrit GORÇE**, i biri i Njaziut, lindur me 17.03.1983 ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftim ID nr. 029189320, me nr. personal H00808030A, me zotesi te plote juridike per te vepruar, Cel. Nr. 0672000828,

**BLERËSI:**

**Lorenc BEDAJ**, i biri i Xhelos, i datelindjes 11.04.1981, lindur ne Golem, Gjirokaster, banuese ne Delvine, identifikuar ne baze te dokument identifikimi, Leternjoftim ID nr. 028008420, numri personal I10411052M, person madhorë, me zotësi te plote juridike per te vepruar, Cel. Nr. 0695862722,

**BAZA LIGJORE:**

Neni 39/c i Ligjit nr. 7829 date 1.6.1994 "Për Noterinë; Neni 73/b i Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Neni 43 i Ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; Neni 204, 705 e vijues i Kodit Civil.

**MEQENËSE:**

- STUDIO REA-G SHPK eshte nje subjekt tregtar privat e regjistruar ne QKB date 09.03.2018 me **NUIS: L81509036M.**
- Bazuar ne Ekstraktin e QKB leshuar sot date 05.10.2018 rezulton se a) Shitësi/Indrit Gorçe është ortak i vetem i Shoqërisë STUDIO REA-G SHPK pjesmarrës 100% i kapitalit themeltar dhe b) Kapitali i Shoqerise STUDIO REA-G SHPK eshte 100.000,00 leke ku numri i pjeseve eshte 1.
- Shiësi është titullari i vetëm i Kuotës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj.
- Shitesi ka pranuar propozimin e Bleresit per blerjen e teresise se kuotave te zoteruara nga Shitesi ne Shoqerine **STUDIO REA-G SHPK.**
- Ky tranferim kuotash eshte miratuar me Vendim nr. 1 date 05.10.2018 te Asamblese se Ortakeve/Ortakut te Vetem te Shoqerise STUDIO REA-G SHPK.

**ATËHERE:** **PALET BIEN DAKORT PER SA ME POSHTE VIJON:**

**NENI 1 – OBJEKTI I KONTRAËS**

**Me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhe sipas kushteve vijuese, Shitësi, tërësinë e pjesëmarrjes së tij që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë STUDIO REA-G SHPK e transferon te Blerësi, i cili e blen atë dhe behet ortak i vetem i shoqerise, zoterues i saj 100 %.**

**NENI 2 – ÇMIMI I SHITJES**

**2.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë STUDIO REA-G SHPK të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, shiten me vlerën e tyre nominale, për një shumë totale të barabartë me 100.000,00 Leke (njëqind mijë), qe përbën 100% te kapitalit të Shoqërisë.

**2.2.** Çmimi i shitjes i është shlyer Shitësit totalisht nga Blerësi para nënshkrimit te kësaj kontrate, jashtë kësaj zyre noteriale.

**NENI 3 – EFEKTET E TRANSFERIMIT**

Efektet e transferimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë STUDIO REA-G SHPK të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, nisin nga momenti i nënshkrimit të saj.

Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi ushtron të gjitha të drejtat që ligji i njeh zotëruesit të kuotave të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, si nga pikëpamja e ushtrimit të të drejtës së votës dhe të pjesmarrjes në shpërndarjen e fitimit.

**NENI 4 – GARANCITË**

**4.1** Shitësi i jep Blerësit të gjitha garancitë që parashikohen në Kodin Civil të R. Sh. për Shitësin, si dhe e garanton për gëzimin e qetë të titullit të pronësisë dhe vërtetësinë e dokumentacionit bashkëngjitur kësaj kontrate.

**4.2** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi pranon situatën e Shoqërisë, sipas gjendjes së faktit në të cilën ajo ndodhet, dhe se asnjë pretendim i mëtejshëm nuk do të bëhet prej Blerësit në lidhje me këtë.

**4.3** Nga une noteri pasi u kerkua informacion nga Regjistri i Barreve Siguruese dhe nga konfirmi i ardhur rezulton se nuk ka asnje shenim.

**NENI 5 – TË NDRYSHME**

**5.1.** Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim në rrugë bisedimesh do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**5.2.** Kjo kontratë hartohet në 4 kopje në gjuhën shqiptare.

**5.3.** Blerësi mori dijeni te regjistrojë këtë kontratë prane Regjistrit Tregtar brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

**5.4.** Shpenzimet ligjore dhe kontabile, taksat, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të Blerësit.

*Kontrata pasi u redaktua ne kater kopje me vlere te njejte ligjore, ju lexua paleve me ze te larte e qarte, te cilet deklaruan se e kuptuan dhe e pranojne ate, dhe meqenese shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet prej tyre rregullisht dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.*

PALET

**SHITESI**

Indrit Gorgi

**BLERESI**

Lorenc Beda

NOTERE

Alma Poshi

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2018100513916533 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 05.10.2018 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:09:16PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-043-546 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

INDRIT NJAZI GORCE
STUDIO REA-G SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA